

KONGRESI I X-të I EUROSAT-t

Stamboll, 22-25 Maj 2017

KONKLuzionet DHE REKOMANDIMET



Preambul

Tema e Kongresit të X-të të EUROSAT-t është përcaktuar si “Zbatimi i ISSAI-ve; sfidat dhe zgjidhjet” duke qenë një çështje e përbashkët sfiduese për të gjithë anëtarët e EUROSAT-t.

Institucionet Supreme të Auditimit (SAI-t), si mekanizma të pavarur mbikëqyrës për të rritur transparencën dhe llogaridhënien e politikave qeveritare, si dhe për të nxitur marrjen dhe përdorimin efektiv dhe eficient të burimeve publike, duhet ta kryejnë këtë mision jetik duke siguruar cilësinë më të lartë të auditimit. Rruga drejt arritjes së cilësisë më të lartë në procesin auditues lidhet drejtpërdrejt me miratimin dhe zbatimin e duhur të standardeve më të larta ndërkombëtare, përgjithësisht të pranuar, të quajtura "Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI-t)". Megjithatë, ky është një proces sprovues pasi çdo SAI ka dinamika të ndryshme në aspektin e legjislacionit kombëtar, mandatit të auditimit, strukturës

dhe burimeve institucionale. Prandaj, duke pasur parasysh se ISSAI-të nuk janë thjesht një listë e plotë ose një udhëzues për të treguar "*se si të*", SAI-t duhet të shpenzojnë më shumë energji në implementimin e arritjes së një cilësie më të lartë, i cili në thelb nuk është një proces i hapur.

Sa i përket sfidave dhe zgjidhjeve përkatëse, zbatimi i ISSAI-ve është një nga çështjet prioritare. Për këtë qëllim, Kongresi ka evidentuar një entuziazëm të madh të pjesëmarrësve për shkëmbimin e njohurive dhe përvojës dhe për të propozuar zgjidhje për sfidat me të cilat ballafaqohen. Për të rritur vlerën e shtuar të Kongresit në literaturën e auditimit, SAI-t janë inkurajuar të përfitojnë nga 12 seanca dhe seminare të njëpasnjëshme pune. Kjo zhdërvjelltësi ka siguruar diskutimin e temave si në nivel strategjik, ashtu edhe teknik. Llojet e ndryshme të metodave të diskutimit dhe strukturës pjesëmarrëse e kanë kthyer Kongresin në një event të dobishëm, krijues dhe të orientuar drejt rezultateve.

Parimi i dialogut të hapur, i cili është miratuar si një nga parimet kryesore të Gjykatës Turke të Llogarive, reflektohet edhe në Kongres.

Konkluzionet dhe rekomandimet e nxjerra nga Kongresi do të jenë një burim frymëzimi për epokën e re të Planit Strategjik me strukturën e shtuar të qeverisjes.

Konkluzione dhe Rekomandime

Ne, anëtarët e Kongresit të X-të të EUROSAT-t,

Roli i Evoluar i SAI-ve

Duke pasur parasysh që:

- Çështjet e reja globale krijojnë një axhendë të re për SAI-t, si në rast të çështjeve të reja që dalin, ashtu dhe në rastin e QZHQ-ve (Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm);
- Mjedisi që ndryshon shpejt kërkon më shumë iniciativë dhe reagueshmëri nga SAI-t në përgjigje të atyre çështjeve në zhvillim dhe QZHQ-ve;
- ISSAI-t janë udhëzues të paçmueshëm për SAI-t që të ecin drejt rrugës së auditimit të kualifikuar; dhe
- EUROSAT është një nga organizatat rajonale më aktive të INTOSAT-t.

Arrijmë në përfundimin se:

- Zhvillimi i mjeteve të reja të auditimit është vendimtar për t'iu përgjigjur nevojave të shoqërisë në mënyrën më të mirë;

- ISSAI-t duhet të përshtaten në përputhje me nevojat e SAI-ve që rezultojnë nga ndryshimi i mjedisit; dhe
- Ndarja e njohurive dhe eksperiencës në kuadër të EUROSAT-t është shumë e rëndësishme për t'iu përgjigjur çështjeve në zhvillim.

Rekomandojmë që:

- SAI-t duhet të jenë më të shkathët dhe reaktivë;
- EUROSAT duhet të përditësojë misionin e tij në përputhje me rolin evolues të SAI-ve;
- EUROSAT të inkurajojë INTOSAT-n për të zhvilluar ISSAI të reja për t'ua adresuar siç duhet çështjeve në zhvillim e sipër;
- EUROSAT duhet të ndjekë qasjet e INTOSAT-t në arritjen e QZHQ-ve;
- Për të arritur qëllimet e auditimit brenda QZHQ-ve, auditimet bashkëpunuese janë mjete jetike;
- EUROSAT duhet të kërkojë mënyra për të adresuar ndikimin e QZHQ-ve në rishqyrtim të mënyrës se si duhet të auditohet administrata publike; dhe
- EUROSAT duhet të përqëndrohet në përgatitjen e duhur të audituesve për të kryer auditimet e QZHQ-ve.

Zgjidhje Frymëzuese për Përmirësim të Mëtejshëm

Duke pasur parasysh se publikimi i gjetjeve të auditimit është një sfidë dhe shpesh ka praktika të ndryshme ndërmjet SAI-ve, EUROSAT rekomandon që timoni kryesor të jetë komunikimi i suksesshëm me palët e interesit pa kompromentuar pavarësinë e SAI-ve.

Duke marrë parasysh sfidat që lidhen me auditimin e IT-së (të tilla si integrimi i tyre në auditimin e performancës, arritja e inovacionit të të dhënave, analiza e riskut, qasja në mësimdhënie dhe zhvillimi i bazës së njohurive të SAI-ve) EUROSAT rekomandon;

- Ndarjen dhe ndjekjen e praktikave të mira të auditimit të IT-së dhe të performancës;
- Identifikimin e të gjitha pengesave që zvogëlojnë mundësinë e kryerjes së auditimeve të IT-së;
- Përfshirjen e auditimit të IT-së në Strategjinë e SAI-t;
- Mbatjen e një përshkrimi të përditësuar të fushës së IT-së të të gjithë të audituarve dhe të bazës së të dhënave të portofolit të ndërtimit të të gjitha projekteve të rëndësishme të qeverisjes elektronike (e-Government); dhe
- Sigurimin e programeve të trajnimit në stafin e auditimit të IT-së.

Duke marrë parasysh që çdo SAI ka një strukturë unike organizative dhe qasje të ndryshme të auditimit, EUROSAI arrin në konkluzionin se ISSAI-të në fushën e auditimit të performancës të sigurojnë një kornizë të qëndrueshme dhe jo thjesht të shërbejnë si “numër” dhe nënvizon se aplikimi i standardeve duhet të çojë në një përmbajtje më cilësore.

Duke konsideruar se katastrofa është bërë një çështje e rëndësishme dhe një fushë me shqetësim në rritje për SAI-t dhe për komunitetin ndërkombëtar, dhe se ISSAI 5500 është mbështetur nga INTOSAI si përgjigje e SAI-ve për ndryshimin e politikave ndërkombëtare, EUROSAI rekomandon që INTOSAI t'i përditësojë, duke marrë parasysh emergjencat siç janë migrimi masiv, sulmet kibernetike dhe nevoja për të vlerësuar kontributin e SAI-ve në përmirësimin e llogaridhënies në një strukturë që përbëhet nga partneritete të jashtëzakonshme shumësektoriale, bashkëpunime shumëpalëshe dhe organizata vullnetare.

Duke pasur parasysh se jemi të rrethuar nga shumë të dhëna dhe informacione për të analizuar përpara auditimin *ex-ante* dhe vendimet publike nuk mbështeten gjithmonë në rezultate të përshtatshme të matshme, EUROSAI rekomandon t'i kushtohet vëmendje e duhur analizave të të dhënave dhe informacionit brenda proceseve audituese dhe të përdorin të gjitha mjetet dhe teknikat analitike të disponueshme të fokusuara në veçanti në vlerësimin e nivelit të treguesve të qëllimit të zhvillimit të qëndrueshëm në rang kombëtar.

Duke pasur parasysh se një nga aspektet kryesore të zbatimit praktik të ISSAI-ve në fushën e auditimit dhe etikës është edukimi dhe trajnimi mbi etikën në SAI, EUROSAI konkludon se një trajnim efektiv mbi etikën është një proces afatgjatë dhe i vazhdueshëm që nuk siguron efekte të menjëhershme.

Duke pasur parasysh se edhe pse revolucioni dixhital lehtëson grumbullimin e të dhënave dhe mundëson analizë të shpejtë të grupeve të të dhënave të mëdha në vend të marrjes së mostrave, hartimi i të dhënave nga baza të ndryshme të dhënash mbetet një sfidë, EUROSAI rekomandon një përgatitje më të mirë para auditimeve dhe automatizimit të të dhënave.

Duke marrë parasysh se mandatet e auditimit të SAI-ve janë të ndryshme, EUROSAI konkludon se ISSAI-t ofrojnë një kornizë të përbashkët veçanërisht për auditimin financiar dhe rekomandon që ISSAI-t të harmonizohen me kornizat ligjore kombëtare të SAI-ve. Rishikimi dhe sigurimi i kontrollit të cilësisë dhe të cilësisë duhet të jenë fokusi në auditimet e certifikimit.

Duke marrë parasysh se monitorimi është një pjesë e domosdoshme e auditimeve të cilësisë së lartë dhe ka rëndësi të madhe për t'iu përgjigjur pritshmërive të shoqërisë dhe të taksapaguesve, EUROSAI rekomandon diskutime të mëtejshme për zhvillimin e monitorimit të gjetjeve të auditimit.

Duke pasur parasysh se komunikimi midis SAI-ve, si dhe me aktorë të tjerë, është një mjet jetik për të zbuluar sfidat e vërteta në zbatimin e ISSAI-ve dhe se fokusimi në shtimin e më shumë vlerave për jetën e qytetarëve është vendimtar, EUROSAT konkludon se SAI-t duhet të kryejnë auditime me qëllim maksimizimin e vlerës së shtuar dhe duhet të kryejnë kombinime të ndryshme të llojeve të auditimit (veçanërisht auditim të performancës përmes metodologjive që përputhen me kornizën përgjithësisht të pranuar).

Së fundmi, EUROSAT rekomandon përmirësimin e zbatimit të ISSAI-ve dhe, nëse është e mundur, reflektimin e ISSAI-ve në progresin e SAI-ve.